



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA LEZHË
KRYETARI

PROJEKTVENDIM

Nr. 2169, datë 15.02.2021

“PËR
PËRCAKTIMIN E STRUKTURES SË BANIMIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT NË
VLERË MONETARE PËR SUBJEKTET PËRFITUESE TË GRANTIT TË
RINDËRTIMIT TË CILËT KANË ZGJEDHUR QË NDËRTIMIN
E BANESAVE TA BËJNË VETË ”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, vendimit nr. 887, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.115, datë 26.08.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindertimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.141, datë 14.10.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindertimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.18, datë 04.02.2021 “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rindertimi, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh DS4 dhe DS5 dhe duhet të rindertohen nga e para”, Kryetari i Bashkisë i paraqet për miratim Këshillit të Bashkisë Lezhë,

PËR TË VENDOSUR :

1. Përcaktimin e struktures së banimit dhe masës së përfitimit në vlerë monetare për subjektet përfituese të grantit të rindërtimit të cilët kanë zgjedhur që ndërtimin e banesave ta bëjnë vetë, sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij projektvendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI

Pjerin NDREU

